



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 39 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28/03/2024

VENDIM
Nr.09, datë 28 /03/2024

PËR
PROJEKTIN E INSTALIMIT TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK ME FUQI 8.25 MWp
NË ANËN E POSHTME TË DIGËS SË ZADEJËS NË HEC-in VAU I DEJËS.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 32, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), neni 4 në mbledhjen e datës 28.03.2024 mori në shqyrtim Projektin e zbatimit për Instalimin e Impiantit fotovoltaik me fuqi 8.25 MWp në anën e poshtme të digës së Zadejës në HEC Vau i Dejës. KKDM u përqëndrua në dokumentacionin teknik në lidhje me Aspektet strukturore, ndërtimore dhe të qëndrueshmërisë së digës si dhe në monitorimin e digës dhe të impiantit FV në të ardhmen pas vendosjes së tij në digë.

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga KESH sha si shfrytëzues i kësaj dige, kushtet aktuale të digës, oponencën e Institutit të Ndërtimit, eksperiencave ndërkombëtare në instalimin e Impianteve FV në diga me material vendi si dhe kërkesave të legjislacionit të mësipërm, KKDM,

VENDOSI:

- 1- Të Miratojë Projektin e Zbatimit të paraqitur nga KESH sh.a për Instalimin e Sistemit fotovoltaik me fuqi 8.25 MWp në anën e poshtme të digës Zadejë në HEC Vau i Dejës.
- 2- Ti kërkoj KESH sh.a si shfrytëzues i digës dhe nënobjekteve të saj:
 - o Krijimin e mundësisë së hyrjes tek të gjithë elementet e sistemeve të monitorimit të digës dhe nënobjekteve të saj përmes rrugëve hyrëse me gjërësi jo me pak se 2 m edhe pas instalimit të elementeve të Sistemit FV në anën e poshtme të digës. Në mënyrë të vecantë të krijohet mundësia e hyrjes tek sistemet e monitorimit të vendosur në mesin e digës nga kurora e digës deri në fundin e saj duke mos instaluar panele FV në këtë zonë.
 - o Kontrollin e të gjithë elementet e sistemeve të monitorimit të digës që janë instaluar aktualisht dhe nëse është e nevojshme, të kryejë përshtatjen e tyre në kushtet e reja me qëllim kryesor funksionimin e tyre në të ardhmen pa probleme dhe kryerjen e monitorimit të digës në cdo kohë. Në mënyrë të vecantë, Sistemi i monitorimit gjeodezik dhe piezometrik duhet të jenë ëe funksion të plotë për matjet e kërkuara gjatë vitit. Njëkohësisht, duhet të bëhen matjet e temperaturave sipër dhe poshtë paneleve FV në të paktën 8 pika të shpërndara në mënyre uniforme duke krijuar bazen e të dhënave të matjeve të temperaturave në zonë. KESH duhet të përditësoj skemat e monitorimit të digës si dhe rregulloren e monitorimit të digës së Zadejës dhe të Qyrfaqit të HEC Vau i Dejës në funksion të kushteve të reja të krijuara nga instalimi i impiantit FV në digë. Rregullorja e re e monitorimit të këtyre digave duhet të paraqitet për miratim në KKDM.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Marrjen e masave për një drenazhim sa me të mirë të zonës ku do të vendosen bazamentet e betonit dhe strukturat mbajtëse të paneleve FV për të eliminuar cdo efekt të erozionit sipërfaqësor që mund të krijohet në biefin e poshtëm. Në mënyrë të veçantë, të kontrollohen kapacitetet percjelles të kanaleve ekzistues të grumbullimit dhe largimit të ujrave sipërfaqësore në 4 bërnat e anës së poshtme të diges.
- Zbatimin e kërkesave të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 20, 21 dhe 24 në lidhje me mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve që do të kryhen për zbatimin e këtij projekti,
- Monitorimin e diges në mënyrë të veçantë gjatë zbatimit të punimeve për instalimin e impiantit FV dhe raportimin cdo 3 muaj në KKDM për rezultatet e monitorimit duke përfshirë një protokoll monitorimi të veçantë dhe rezultatet e të dhënave të matjeve të monitorimit.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI